

Prurqëtim orejt identitetit

GEISTERGESCHICHTE



Kopertina originale

Përmbledhja e veprës

Ana, pianiste, dhe Tomasi, profesionist në fushën e kinematografisë, pesëdhjetë vjeç secili, jetojnë prej dy dekadash në të njëjtin apartament në Vjenë. Ata e dinë se cili prag kërcet, cila derë sapo u hap, ku ndodhet tjetri. Tomasi, e kalon pjesën më të madhe të kohës së tij në takime pune, edhe jashtë qytetit. Ana kalon gjithnjë dhe më shumë kohë e vetme në apartament. Kur e kalon natën në shtëpi, ai nuk fle më në dhomën e përbashkët të gjumit, e cila tani është "dhoma e Anës", por fle në studion e tij, mbi divan.

Ana është e bindur që Tomasi ka një lidhje të fshehtë.

Dhe kjo s'do të ishte e para. Ka ndodhur edhe një herë tjetër. Në atë kohë Ana s'fuste gjë në gojë. "Ajo filloi të hante përsëri, kur gruaja tjetër s'ekzistonte më dhe Tomasi s'arrinte ta kuptonte nga e mësonte Ana që ai po e gënjente."

Ana aktualisht ka marrë një vit pushim. Ajo është mësuese pianoje në një shkollë muzike. Gjatë këtij viti dëshiron të luajë përsëri vetë në piano.

Por ende pa filluar viti i lirë i Anës, lidhja e fshehtë e Tomasi dhe Ana e çorodit krejt. Ajo s'përqendrohet dot më në asgjë. Në shtëpi s'fut dot më gjë në gojë, i përzihet menjëherë, kështu që mëngjesin e ha çdo ditë në kafene. Bllokun e shënimeve ngjyrë blu e mban pranë vetes, por s'shkruan gjë kurrë. Pasi pi kafën del përsëri shëtitje, të cilat shndërrohen në ekskursione nëpër qytet. Këpucët e saj të bukura i zëvendëson me një palë atlete, çantat e dorës me një çantë shpine e ditë pas dite endet dhe endet. Ajo arrin gjithnjë e më larg, në rrethinat e jashtme të qytetit, në zona gjithnjë e më të panjohura.

HISTORI SHPIRTRASH

13x20 cm

168 faqe

1200 lekë

Kopertina në versionin shqip ©Elvin Shahu



Përveç kësaj ajo s'luan dot më në piano. Duart s'lëvizin ... ato sillen sikur të mos kishin luajtur kurrë.

Ajo është e bindur që Tomasi ka dashnore, sheh vazhdimisht një grua të re, një vajzë, duke ecur tinëz nëpër apartament, ose duke parë nga dritarja. Ajo fillon të presë rregullisht për vajzën. Ana fillon gjithashtu të kërkojë fatura nëpër xhepat e Tomasit. Fatura restoranti, fatura kanefesh dhe gjëra të ngjashme. I rendit ato sipas radhës, imagjinojnë se si janë ulur ata të dy, çfarë bisedojnë me njëri-tjetrin duke u futur gjithnjë e më shumë në botën e burrit të saj dhe vajzës (siç do ta thërrasë gjithmonë). Laura Freudenthaler arrin të ndërthurë në një mënyrë shumë unike realitetin dhe trillimet. Realiteti objektiv s'ekziston më dhe është e vështirë të ndash të vërtetën nga fantazia. Si lexues fillon ta shohësh botën përmes syve të Anës dhe zhytesh bashkë me të në realitetin e saj.

Pjesë nga romani në shqip

Ana dëgjon të hapet dera e apartamentit, e mbyllur me çelës. Pastaj mbyllet përsëri butësisht. Doreza ngrihet ngadalë lart. Tomasi përkulet, por e tradhton xhaketa, zhurma e materialit të saj. Shkon në kuzhinë, mbathur vetëm me çorape, dysHEMEJA kërcet. Pragu midis paradhomës dhe kuzhinës bën një zhurmë karakteristike, sikur thërrmohet diçka. Ana e dëgjon dy herë këtë krisje, pastaj derën që të çon në studion e Tomasit, doreza e së cilës duhet mbyllur edhe një herë nga brenda, që gjuhëza të mos kërcëjë jashtë. Kur je duke shkuar nga kuzhina për në studio, shikon dritaren e dhomës së ndenjjes, përpara së cilës Ana qëndron ulur në kanape si statuja e Zojës, me shpinën nga vëzhguesi dhe fytyrën drejtuar nga muri, i cili s'është mur. Nëse në pallatin përballë dikush do të qëndronte në errësirë në dritare, mund ta shihte fytyrën e Anës. Në shpellat e jugut statujat e Zojës, me lule plastike poshtë këmbëve, mbrohen me xham. Ana bën një hap pas dhe sheh reflektimin e saj. Rrudhën midis vetullave. Mundohet t'i tërheqë tëmthas në të dyja anët, njëlloj sikur gishtat të ledhatonin rrudhën, pastaj pjesën e ballit deri te kurora e flokëve, por pa i lëvizur duart. Ajo largohet nga banesa për një shëtitje të shkurtër. Ndien ajrin e ftohtë në pulpa. Gjatë vitit të parë të bursës jashtë shtetit, Ana kthehej çdo mbrëmje në shtëpi, pasi ishte ushtruar tërë ditën në konservator. Errësira i dukej miqësore dhe e zgjaste rrugën e kthimit, duke u endur në qytetin që e njihte ende pak. Nëse i pëlqente ndonjë bar, futej brenda dhe porosiste një kafe. Ajo mund të pinte kafe në mbrëmje dhe ta zinte gjumi përsëri. Shitorja te qoshja është ende hapur. Mbase Tomasi do të hajë ndonjë gjë. Kur ajo kthehet, ai e pret i ulur në kuzhinë. Ndonjë gjë të vogël, i thotë ai. Ana i thotë se mund të bëjë makarona me pesto. Pesto e mirë, thotë ajo, e përgatitur vetë, e ka bërë një kolege. Derdh makaronat në tenxhere dhe i lutet Tomasit të shohë nëse parmixhani është ende i freskët. Kur e shpaketoi, pa një njollë në koren e tij, e cila iu duk si myk. Tomasi i hedh një vështrim djathit. Pse s'duhet të jetë më i freskët. Mund të dalësh pa kapuç jashtë, kohë e mrekullueshme. Seriozisht e ke, i thotë Tomasi, era është e ftohtë, të futet lehtësisht në vesh. Ana mënjanon kokën dhe ngre shpatullën e djathtë drejt veshit. Marrëzi, thotë ajo dhe lëshon supet. Po vjen pranvera.

Pjesë nga romani në gjuhën origjinale

Anne hört, wie die Wohnungstür aufgesperrt und geöffnet wird. Behutsam wieder geschlossen. Langsam wird die Klinke nach oben bewegt. Thomas bückt sich, seine Jacke verrät ihn, das Geräusch des Stoffes. Er geht auf Socken in die Küche, der Boden knarrt. Die Schwelle zwischen Vorzimmer und Küche erzeugt einen eigenen Laut, als würde etwas auseinanderbrechen. Anne hört das Knacken zweimal, dann die Tür zu Thomas' Arbeitszimmer. Er muss sich von innen noch einmal dagegen lehnen, damit sie nicht wieder aufspringt. Wenn man von der Küche ins Arbeitszimmer geht, sieht man auf das Wohnzimmerfenster, vor dem Anne steht wie eine Madonnenstatue in ihrer Nische. Sie steht mit dem Rücken zum Betrachter, das Gesicht zur Wand. Es ist aber keine Wand. Wenn im Haus gegenüber hinter einem der dunklen Fenster jemand stünde, könnte er Annes Gesicht betrachten. In Grotten im Süden sind Madonnenstatuen durch Glas geschützt, zu ihren Füßen liegen Plastikblumen. Anne tritt einen Schritt zurück und sieht nun ihre Spiegelung. Die Falte zwischen den Augenbrauen. Sie versucht die Schläfen nach beiden Seiten hin zu verlängern, als strichen ihre Finger von der Falte weg über die Stirn bis zum Haaransatz, ohne aber die Hände zu heben. Sie verlässt die Wohnung für einen kurzen Spaziergang. An den Waden spürt sie die kalte Luft. Im ersten Jahr des Auslandsstipendiums ist Anne jeden Abend nachhause gegangen in ihr Zimmer, nachdem sie den ganzen Tag am Konservatorium geübt hatte. Sie fand die Dunkelheit freundlich und dehnte den Heimweg durch die Stadt, die sie noch wenig kannte, aus. Wenn ihr eine Bar gefiel, setzte sie sich hinein und bestellte einen Kaffee. Sie konnte abends Kaffee trinken und trotzdem schlafen. Der Supermarkt an der Ecke hat noch offen. Thomas will vielleicht etwas essen. Als sie zurückkommt, sitzt er in der Küche. Eine Kleinigkeit, sagt er. Anne bietet Nudeln mit Pesto an. Gutes Pesto, sagt sie, von einer Kollegin selbstgemacht. Sie gießt die Nudeln ab und bittet Thomas nachzusehen, ob der Parmesan noch gut ist. Beim Auswickeln hat sie auf der Rinde einen Fleck gesehen, den sie für Schimmel hält. Thomas wirft einen Blick auf den Käse. Warum soll der nicht mehr gut sein? Man könne ohne Haube draußen sein, sagt Anne, es sei herrlich. Du bist unvernünftig, sagt Thomas, der Wind ist kalt, das geht schnell auf die Ohren. Anne legt den Kopf schief und zieht die rechte Schulter zum Ohr. Unsinn, sagt sie und lässt die Schulter sinken. Es wird Frühling.



Mbi autoren:

Laura Freudenthaler, u lind në vitin 1984 në Salzburg. Ajo ka studiuar gjermanisht, filozofi dhe për çështje gjinore. Aktualisht jeton në Vjenë.

Fillimisht ka botuar një libër me tregime "Der Schädel von Madeleine", në vitin 2014.

Romani i saj i parë "Mbretëresha hesht" është vlerësuar me çmimin "Förderpreis zum Bremer Literaturpreis 2018" dhe si debutimi më i mirë gjerman i vitit 2018 në Festivalin e romanit debutues në Chambéry". Në vitin 2019, ka botuar romanin e saj të dytë "Histori shpirttrash", i cili është fitues i "Çmimit European për Letrësinë" (EUPL) 2019.



Mbi përkthyesen:

Irena Nasi është lindur më 1978. Është diplomuar në Universitetin e Tiranës si përkthyes dhe interprete e gjuhës gjermane. Më pas ka ndjekur edhe disa kurse të ndryshme pasuniversitare. Aktualisht është përkthyes pranë Ambasadës Austriake Tiranë.

Ajo ka përkthyer mjaft vepra nga letërsia gjermane si: "Histori shpirttrash", roman i autores austriake Laura Freudenthaler; "Tri rrugë për te liqeni", përmbledhje me novela e autores austriake Ingeborg Bachman; "Blu safari", roman i autores gjermane Kerstin Gier; "Dashnori i gjysmëhijes", përmbledhje me tregime e autorit gjerman Alfred Andersh; "Nazisti dhe berberi", roman i autorit gjerman Edgar Hilsenrath; "Mashtuesja", roman i autores austriake Kristinë Gren; romanet "Fundjava", "Leximtari" dhe përmbledhjen me tregime "Lektisje dashurie", të autorit gjerman Bernhard Shlink.